

FJALA E DEPUTETIT ERVIN SALIANJI

E ENJTE 27 JANAR 2022

Të nderuar kolegë,

Të nderuar qytetare dhe qytetarë të Republikës së Shqipërisë,

Për fat të keq, kjo javë, që nga nisja e saj ditën e hënë dhe gjatë gjithë javës, ka pasur vetëm lajme të zeza në raport me Shqipërinë. Lajme të zeza që vijnë nga brenda vendit, lajme të zeza që vijnë nga jashtë tij, nga organizatat ndërkombëtare, të cilat monitorojnë qeveritë në të gjithë globin. Rekordi i nivelit të borxhit publik, borxhi publik më i lartë i deklaruar në 30 vjetët e fundit të ekzistencës së këtij vendi, ishte një prej lajmeve të kësaj jave. Rekord negativ edhe marrja e tatëpjetës në perceptimin e publikut në përhapjen e korrupsionit në çdo qelizë të këtij shteti dhe të kësaj qeverie ishte raporti i Organizatës Ndërkombëtare TIA, e cila e vendos Shqipërinë nga viti në vit keq e më keq, për shkak të keq-qeverisjes së kësaj qeverie. Pamundësia për të siguruar jetesën, gjendja e keqe ekonomike, pamundësia për t'u ngrohur pensionistët e familjet në nevojë, por jo vetëm e ata, por edhe pamundësia dhe dorëzimi i shtetit dhe i qeverisë për të siguruar ngrohje dhe për të mundësuar që fëmijët e këtij vendi të shkojnë në shkolla normalisht, na detyron, për shkak të një moti, i cili, në krahasim me vendet e rajonit apo me një shtet, i cili është gjysma tjetër jona, Kosovën, më të pranueshëm dhe shumë më pak të ashpër, t'i mbyllim shkollat e t'i lëmë fëmijët në shtëpi; kjo për shkak të pamundësisë së shtetit dhe të paparishikueshmërisë që shteti bën në këto situata.

Nga ana tjetër, kemi një betejë, jo për qytetarët, që i ka zënë mediet; një gjuhë banale e përfaqësuesit më të lartë të Partisë Socialiste në Bashkinë e Tiranës, i cili, për shkak të interesave mesquine dhe interesave pothuajse personale të kësaj maxhorance, në të vetmin ishull pushteti pa kontroll, siç është Federata Shqiptare e Futbollit, t'i turret asaj me kuç e me maç, duke nxitur ose jo, të presim hetimet, si edhe në situata të tjera shpërthime të tritolit brenda vendit, të cilat po ndodhin përditë, ose tritol, ose vrasje, ose tentativë për vrasje, duke krijuar një gjendje paniku dhe klime pasigurie në këtë vend. Ashtu siç po ndodh këtu, po ndodh edhe nëpër vende të tjera, ku shqiptarët vriten në Ekuador, për shkak të kontrollit të drogës dhe të përfshirjes në trafik droge. Ashtu siç thotë raporti i Departamentit Amerikan të Shtetit: "Shqipëria është kthyer në qendër operationale të trafikimit të drogave të forta". Vrasje shqiptarësh po ashtu në Belgjikë, kudo, për shkak të një projekti politik të kësaj maxhorance që e kanabizoi Shqipërinë, krijoi dhe lehtësoi infrastrukturën kriminale të trafikut të drogës, e cila po shërben sot edhe për trafikun ilegal të emigrantëve. Në këtë situatë pasigurie, në këtë situatë ku edhe aktet, që vijnë dhe paraqiten sot në mënyrë të përsëritur e të përsëritur, japin mundësi për rivlerësimin e pasurisë, ndërkohë që Shqipëria është ndër vendet më të ekspozuara për pastrimin e parave. Të gjitha këtyre që sapo thashë, si u përgjigjet qeveria? Me tallje, Edi Rama del e thotë me një, jo papërgjegjshmëri, por me një tallje ekstreme: "Për këshillim kombëtar", e quan, pra të riktheheni dhe të dalë hapur në këtë moment si një autokrat tjetër, ku do të kthejë devizën: "Ç'thotë populli, bëka partia". Ndërkohë që vendet demokratike, vendet me demokraci, e kanë të zgjidhur, nuk kanë nevojë për këshillim kombëtar për çështje të rëndësisë së veçantë; kanë nevojë t'i nënshtrohen votës dhe të kalojnë në referendum, që e kemi propozuar, e kemi pasur një ndër pikat ku kemi potencuar gjatë fushatës elektorale si një nevojë e domosdoshme për ta kaluar vendimmarrjen te qytetarët. Por përveç instrumentit, me të cilin po zgjedh të tallet me qytetarët shqiptarë, shikoni pyetjet, të cilat

mbase kanë kaluar me vëmendje ose kanë kaluar pa vëmendje. Në të gjithë këtë situatë shqetësuese për qytetarët shqiptarë shqetësimi më i madh i qeverisë, e cila duket se jeton në një univers paralel, është: “A janë dakord shqiptarët për t’u legalizuar kanabisi apo jo?” Kjo është një ndër pyetjet që Kryeministri kërkon që qytetarët shqiptarë t’i japin përgjigje. Pra, a janë dakord qytetarët shqiptarë të ketë një amnisti të përgjithshme që, pasi të legalizohet kanabisi, të legalizohen edhe asetet kriminale dhe paratë e krimit me një projektligj të tërhequr për shkak jo të mosdakordësisë, por të refuzimit nga BE-ja, nga Fondi Monetar Ndërkombëtar, sepse, siç thuhet në relacionin e paraqitur nga qeveria, projektligji parashikon lejimin e legalizimit të aseteve të paligjshme kundrejt një tarife simbolike prej 5%?! Pra, të gjithë që merren në këtë vend me trafik, të gjithë njerëzit, që kanë pasuri të paligjshme të krijuara nga aktiviteti kriminal apo nga aktiviteti korrupsion, qeveria kërkon t’i legalizojë dhe t’i futë në sistem, madje duke i taksuar me 5%.

Ndërkohë që barra fiskale për shumicën e qytetarëve shqiptarë shkon deri në 40%, ndërkohë që barra për shtresën e mesme në këtë vend dhe taksa progresive rëndon më shumë shtresën e mesme se cilindo qytetar tjetër apo se çdo oligark që është i lidhur drejtpërdrejt me qeverinë. Duket qartë se interesi i qeverisë shqiptare nuk është interesi publik, nuk është interesi i qytetarëve shqiptarë, nuk është interesi i shtetit shqiptar, por është interes thellësisht personal i një grushti njerëzish, të cilët e kanë pompuar me vota këtë qeveri, këtë maxhorancë në zgjedhje; është detyruar qeveria të bashkëpunojë me këta elementë kriminalë për të siguruar masivisht vota. Sot është e detyruar të sjellë projektligje, të cilat nuk i shërbejnë në asnjë dimension publikut, por i shërbejnë personalisht vetëm tarafit të Edi Ramës. Ne nuk mund të jemi dhe nuk mund të bëhemi pjesë e kësaj. Nuk do të bëhemi pjesë e lojërave të një pjesë prej ish-kolegëve tanë të PD-së, për të cilët pa diskutim për disa kam respekt, por për disa respekti duhet të mungojë nga të gjithë, sepse është nisur një betejë për një person, i cili është shpallur “non grata” dhe nuk ka ardhur as një ditë të vetme në këtë parlament, sepse është pjesë e së njëjtës lojë që bëhet me ju këtu: të bëjmë sikur bëjmë luftë, të bëjmë sikur bëjmë përpjekje, të bëjmë sikur marrim vëmendjen vetëm të PD-ja, ndërkohë që në këtë parlament kalojnë, ashtu siç kalojnë, pa zhurmë, pa debat publik, dhe legalizohen asetet, pasuri, lehtësohen grupet kriminale dhe njerëz, të cilët kanë bashkëpunuar me të gjitha qeveritë në këta 30 vjet. Këta, që janë përgjegjës të 30 vjetëve, qenkan tani shpëtimtarë të 30 vjetëve për të zgjidhur të gjitha ato që kanë krijuar si problematika për shqiptarët në 30 vjet! Prandaj qytetarët shqiptarë janë të qartë në atë që kanë zgjedhur, do të jenë dhe më të qartë nga dita në ditë për t’u ndarë një herë e mirë nga një e shkuar, që nis këtu dhe përfundon në disa të ashtuquajtura “foltore” të tjera.